



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga UÇK-së nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Dhe

Ndërmarrja Private Tregtare" Ane " Nena Tereze, Nr. 249, Fushë Kosovëme numër te regjistrimit te biznesit 810468034 (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

Nr. i prokurimit ¹	616	19	69	211
-------------------------------	-----	----	----	-----

Neni 1 Lënda 1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve dhe punëve të mirëmbajtjes në vijim: Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit sipas specifikimet teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e puneve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasi e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjëren prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjesë (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendorur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë; të përmendura në 1.1.

1.4 Ofruesi i shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasia për disa artikuj.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

1.5 Kontrata hynë në fuqi në datën e përcaktuar në planin e menaxhimit dhe përfundon në një periudhë prej maksimum 36 muajsh.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Kohëzgjatja e kontratës është 36 muaj.

2.2 Vendi i ekzekutimit të shërbimeve dhe punëve do të jetë në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i peshuar i shërbimeve është: **14.77 €; (katërmëdhjetë pike shtatëdhjetë e shtate euro)**, vlera indikativë e kontratës është **190,000 me devijim te lejuar + - 30%**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do tëjenë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4.ZKA me nënshkrimin e kësaj kontrate merr përgjegjësinë për sigurimin e mjeteve për pagesë, ndërsa Opër shqyrtimin e oferave dhe zgjedhjen e kontraktuesit bazohet në vlerësimin e komisionit profesional, të cilët janë përgjegjës për vlerësimin e kriterieve të përzgjedhjes dhe përbajtjen e ofertave të operatorëve ekonomik.

5.5 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhen Shqipe në katër origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për kontraktuesin
Emri:	Zekë Bardhaj	NAIM BERISHA
Pozita:	Udhëheqës i prokurimit	DREJTORZ
Nënshkrimi:		
Data:	09.07.2019	09.07.
Vula:		

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvëç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Detyrimet

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do

të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përvç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përvç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nationale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbillyur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së konratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret konratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e konratës.

Neni 10 Ndërprerja e Konratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë konratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas konratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas konratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të konratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të konratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmitt e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me konratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të konratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të konratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përm bushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13

Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;

- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhëni e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15

Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16

Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë APP-ja për shkelje të tillë. APP-mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga APP.

Neni 17

Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkijnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18

Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19

Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/apo
- ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të jenë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbliimi

22.1 Ofrojësi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofrojësit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofrojësit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofrojësi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofrojësi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
--	---

Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve do te jete e përcaktuar ne planin e menaxhimit
	6.4	Data e Përfundimit do te jete 36 muaj prej ditës se nënshkrimit te planit te menaxhimit
Vendi i kryerjes së shërbimeve	6.5	Ne objektet shëndetësore te Komunës se Prishtinës
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim te ZKA-së.
Dëmet e likuiduara	13.1	<p>Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.</p>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit 19,000 euro për 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	<p>Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.</p> <p>Meqenëse realizimi i shërbimeve do të bëhet në dy faza per qdo vit pagesat do të bëhen pas përfundimit te qdo trajtimi. Pagesat do te behen ne gjithsej 6 situacione.</p>

Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>[shëno]</i> Periudha Garantuese e Defekteve është <i>[shëno datën]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëves hjes	20.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëves hjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë</p> <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>Ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës</p>

Prokurimi: 616-19-2132-2-1-1

Nr i brendshëm: 616 19 69 211

Tituli: Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

1 Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

Kodi i tenderit: L2452019

Data: 24.05.2019

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	CERTIFIKATAT ISO.rar
2.	DIPOLOMA MARREVESHJET.rar
3.	DOKUMENTAT DHE SIGURIMI SCAN.rar
4.	DOKUMENTET E KOMPANISE.rar
5.	KONTRATA DHE REFERENCA 1.rar
6.	KONTRATA DHE REFERENCA 2.rar
7.	KONTRATA TE PUNETOREVE 1.rar
8.	KONTRATA TE PUNETOREVE 2.rar
9.	PAISJET.rar
10.	PASQYRAT FINANCIARE.rar
11.	REFERENCA.rar

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	Paramasa.xlsx

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

**CERTIFIKATAT ISO
DIPOLOMA MARREVESHJET
DOKUMENTAT DHE SIGURIMI SCAN
DOKUMENTET E KOMPANISE
KONTRATA DHE REFERENCA 1
KONTRATA DHE REFERENCA 2
KONTRATA TE PUNETOREVE 1
KONTRATA TE PUNETOREVE 2
PAISJET
PASQYRAT FINANCIARE
REFERENCA**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-19-2132-2-1-1

Titulli i kontratës: Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

3. Çmimi total i tenderit është:

14,77 EUR

Dhe në fjalë [shëno çminin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nese aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurredh, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të finansuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

DEKORIMI I QYETETIT PËR FESTATE FUNDVITIT

Nr.	PËRSHKIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi njesi me TVSH	Cmimi total i peshuar	Poentimi %
1	Furnizimi montimi dhe mirëmbajtja e portave hyrëse me dimisone $\geq (3x3x3\text{m})$. <u>Vërejtje:</u> <i>Forma e portave zgjidhet nga organi mbikayrës.</i>	copë		1 5.00 €	0.65 €	13
2	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e drivate dekoruese, ngjyrë të kuqe të ngrohtë.	m'	1 3.00 €	0.03 €	1	
3	Furnizimi, montimi i portaleve me drita dekoruese për vendosje nga shylla në shtyllë, ngjyra duhet të jetë e ngrohtë ose e kuqe ose e bardhë me gjatësi $\geq 8.0\text{m}$ dhe lartësi $\geq 1.0\text{m}$. <u>Vërejtje:</u> <i>Format e portaleve zgjidhet nga organi mbikayrës. Të janë me rrijetë ndriçuese $\geq 220\text{V}$. LED llambat, blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të varen me litarë metalik në pozitë horizontale.</i>	copë			10	
4	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e formave dekoruese-ndriçuese me ngjyrë të ngrohtë të verdhë ose të bardhë me dimisone $\geq 55x150\text{ cm}$. <u>Vërejtje:</u> <i>Format dekoruese zgjidhet nga organi mbikayrës. Duhet të janë me konstrukcion metalik. Të mbulohet me rrijetë ndriçuese $\geq 220\text{V}$ me kablo prej gome. LED llambat duhet të janë në rrijetë ,blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të përforcohen me sajilla.</i>	copë	1 10.00 €	1.00 €	3	
5	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e drivate dekoruese me ngjyrë të verdhë të ngrohtë. <u>Vërejtje:</u> <i>Drita duhet të jetë e punuar me kabllo prej gome me mbrojtje IP44 ku çdo e 10-ta llambë të jetë me blic.</i>	m'		25.00 €	0.75 €	1
6	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e Bredhit artificial me konstrukzion çeliku i mbuluar me degë montuese. <i>Gjatësia e bredhit 10m ,diametri në fund të bredhit $\geq 5.0\text{m}$.</i>	komplet	1 4.00 €	0.04 €	35	
7	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e elementeve dekorative në formë të ziles për vendosje në Bredh me dimisone min15-25cm, ngjyrë të verdhë ose ngjyre të kuqe.	copë	1 30.00 €	10.50 €	1	
			1 8.00 €	0.08 €		